



**AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA FIER
Njësia e Prokurimit**

Adresa : Lagja “Kastriot”, Rruga “Brigada e XI Sulmuese”; Tel/Fax : 034 410 636

Nr. _____ Prot.

Fier, më 20/03/2017

Lënda : Formulari i Njoftimit të Fituesit për tenderin “Rikonstruksion i rruges ”Daullas –Grecalli-Mujalli,Njesia Administrative Qender” Fier”

**AGJENCISE SE PROKURIMIT PUBLIK
TIRANE**

BASHKIA FIER

[Data: 07/04/2017]

Për: Operatorin ekonomik Agbes Konstruksion ” sh.p.k Fier

Adresa ; Lagjja Sheq i Madh Fier

Procedura e prokurimit: **Procedure e Hapur me mjete elektronike.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rikonstruksion i rruges ”Daullas –Grecalli-Mujalli,Njesia Administrative Qender” Fier**” Fier, Shqiperi, sipas Projektit dhe Preventivit të miratuar të cilat janë pjesë e dokumentave të tenderit.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**Shendelli sh.p.k.**”, përkatësisht numri i NIPT-it K07924803N

Vlera totale sipas preventivit **pa TVSH 0 lekë .**

2.B.O. “B-93 sh.p.k. & Eral Konstruksion sh.p.k”,përkatësisht numri i NIPT-it J62903508R & . numri i NIPT-it K82230002K

Vlera totale sipas preventivit **pa TVSH 97 777 777 lekë** (*nentedhjete e shtate milion e shtateqind e shtatedhjete e shtate mije e shtateqind e shtatedhjete e shtate*) dhe **me TVSH 117 333 332 leke**(*njeqind e shtatembedhjete mije e treqind e tridhjete e tre mije e treqind e tridhjete e dy*).

3. Operatori ekonomik **G.P.G.Company sh.p.k.”** përkatësisht numri i NIPT J64324443V

Vlera totale sipas preventivit **pa TVSH 112 846 480 leke** (*njeqind dymbedhjetë milion teteqind dyzete e gjashtë mijë e katerqind e tetedhjetë*) dhe **me TVSH 135 415 776 leke** (*njeqind tridhjetë e pese milion katerqind pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind shtatëdhjetë e gjashtë*).

4. Operatori ekonomik “Agbes Konstruksion” shpk , perkatesisht numri i NIPT-it K32807432W

Vlera totale sipas preventivit **pa TVSH 125 134 525 lekë**(*njeqind e njezet e pesemilion e njeqind e tridhjetë e kater mijë e peseqind e njezet e pese*) dhe **me TVSH 150 161 430 lekë** (*njeqind e pesedhjetë milion e njeqind e gjashtëdhjetë e nje mijë e katerqind e tridhjetë*).

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. O.E “Shendelli” sh.p.k **NIPT-it K07924803N**
2. O.E “B 93 II shpk **NIPT-it J62903508R**
3. O.E “G.P.G.Company sh.p.k. **NIPT J64324443V**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- **Operatori ekonomik "Shendelli" sh.p.k**

Mungon I gjithë dokumentacioni ligjor ,teknik, ekonomik dhe financiar. I mungon formulari I ofertes dhe preventivi I punimeve.

- **B.O. “B-93 sh.p.k. & Eral Konstruksion sh.p.k”**

Sipas kriterëve të vecanta të kualifikimit të DST në piken 2.3/2 kërkohej që Shoqëria duhet të ketë në stafin e tij drejtues:

- | | |
|----------------------|--------|
| Inxhinier pyjesh | 1(një) |
| Inxhinier gjeoteknik | 1(një) |

a- Te gjithë punonjësit e kërkuar me sipër sipas pikës 2.3/2 të jete të shoqëruar me CV, diplome, libere pune dhe duhet të figurojnë në listëpagesat e periudhës Janar –Nëntor të vitit 2016.

b- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek ndërmarrjeje të punësuar, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003.

Nisur nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se B.O B93 dhe Eral Construcion kane paraqitur kontrata pune si Ing. Pyjesh Z. Gazmen Shllaku dhe si Ing Gjeoteknik Z. Ervis Allkanjari. Te dy këta punonjës janë paraqitur me kontrata pune nga shoqëria B 93. Nga verifikimi i dokumentacionit të kësaj shoqërie rezulton se këta punonjës nuk janë në listëpagesat Janar-Qershor 2016. Këta punonjës figurojnë vetëm listëpagesat në muajin Korrik-Nëntor 2016. Kjo në kundërshtim me kërkesat e kërkuara në piken 2.3/2 të DST. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Z. Gazmen Shllaku ka një kontrate pune me page 30.000, nga verifikimi i listëpagesave rezulton se Z. Gazmen Shllaku për muajin Korrik-Nëntor është i siguruar mbi pagën 22.000 dhe jo mbi pagën që është lidhur kontrata. Kjo përben fshehje të ardhurave dhe shmangie të detyrimeve.

Në DST pika 2.3/2 b kërkohej që shoqëritë të kenë një mjek në përbërje të stafit të tyre në zbatim të VKM Nr. 692, date 13.12.2001. Nga verifikimi mjekë ka paraqitur vetëm shoqëria B 93 Z. Luljana Sulaj (Bregasi). Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se mjekja ka kontrate pune me shoqërinë B 93 që daton me 21.10.2016, ndërsa shoqëria Eral nuk ka paraqitur mjekë në stafin e vetë. Nga aktmarrëveshja rezulton se shoqëria Eral ka marrë përsipër të kryej 25% të punimeve dhe të

përfaqësohet me 25 punonjës në baze të aktmarrëveshjes. Kjo në kundërshtim me kërkesat e **DST pika 2.3/2 b**, dhe të **VKM nr.914 date 29.12.2014 nenin 74 pika 3** ku shprehimisht thotë: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim. Ju nuk plotësoni një nga kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST.

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST në piken 2.3/3 kërkohet një punësim mesatar për periudhën , Dhjetor viti 2014 , viti 2015 dhe Janar-Nentor viti 2016 i të pakten 100 personave me kohe të plote pune duke përfshirë stafin e përhershëm;

Nga verifikimi i listë pagesave të shoqërisë B 93 rezulton se një pjesë e stafit të vet nuk janë të siguruar me kohe të plotë pune si kërkohet në DST por janë të siguruar me nga një ditë pune në muaj duke bërë kështu rritjen fiktive të numrit të punonjësve. Për këtë arsye bashkimi i operatoreve ekonomike skualifikohen pasi nuk plotësojnë piken 2.3/3 të DST.

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim. Ju nuk plotësoni një nga kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST.

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST në piken 2.3/4 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës kërkohet që operatorët ekonomik të paraqesin:
 - a. Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (te vlefshme) leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, leje drejtimit për drejtuesin e mjetit të transportit, siguracionin e mjetit, foto të mjeteve, lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë nga B.O B93 dhe Eral Konstruksion rezulton që këto shoqëri kanë paraqitur këta shofer:

1. Luftar DOSTI
2. Altin Dushku
3. Armando Zeqo
4. Arqile Sema
5. Ilija Sema
6. Oltion Fejzulla

Në DST janë kërkuar 6 makina transporti si dhe lejet e drejtimit për drejtuesit e mjeteve të transportit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se B.O nuk plotëson numrin e nevojshëm të shoferëve për makinat e transportit. Vetëm 3 prej punonjësve të paraqitur plotësojnë kushtet për mjetet e transportit dhe konkretisht: Luftar Dosti, Altin Dushku dhe Oltion Fejzulla. Tre punonjësit e

tjetër nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se kane Dëshmi e Aftësisë Profesionale per ekskavator dhe jo per makinat e transportit si është kërkuar ne piken 2.3/4 a) te DST

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim. Ju nuk plotësoni një nga kriteret e veçanta te kualifikimit te kërkuara ne DST.

- **O.E “G.P.G.Company sh.p.k.**

Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST ne piken 2.3/2 kerkohet qe Shoqeria duhet te kete ne stafin e tij drejtues

Inxhinier pyjesh	1(një)
Inxhinier gjeoteknik	1(një)

a- Te gjithë punonjësit e kërkuar me sipër sipas pikës 2.3/2 te jene te shoqëruar me CV, diplome, libreze pune dhe duhet te figurojnë ne listëpagesat e periudhës Janar –Nëntor te vitit 2016.

Shoqëria G.P.G ka paraqitur si Ing. Pyjesh Z. Fatjon Hasko me kontratën e punës Nr. Rep 106 dhe Nr. Kol 55/1 Dt. 23/01/2017 dhe si Ing. Gjeoteknik Z. Ardit Bedhia me kontratën e punës Nr. Rep 107 dhe Nr. Kol 56/1 Dt. 23/01/2017. Ne DST është kërkuar qe edhe këta Ing duhet te jene ne liste pagesat e shoqërisë për muajit **Janar-Nëntor te vitit 2016**. Nga verifikimi rezulton se këta punonjës nuk janë ne listëpagesat e vitit 2016, kjo ne kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3/2 te DST.

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim. Ju nuk plotësoni një nga kriteret e veçanta te kualifikimit te kërkuara ne DST.

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST ne piken 2.3/4 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës
 - Fabrike asfalti (ose me kontrate furnizimi e lidhur para noterit) e shoqëruar me leje mjedisore nga organet kompetente). Ku vendodhja e fabrikës duhet te jete jo me shume se 15 km nga vendodhja e objektit qe prokurohet.

Nisur nga vendndodhjes se fabrikës se asfaltit me adrese “ Lagjja 18 Tetori, pranë rrotundos se Plukut, Lushnje” rezulton qe kjo është ne kundërshtim me largësinë e kërkuar ne kushtet e pikës 2.3/4 te DST.

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim. Ju nuk plotësoni një nga kriteret e veçanta te kualifikimit te kërkuara ne DST.

Duke iu referuar proceurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Agbes Konstruksion**” shpk”, Sheq i Madh Fier, se oferta e paraqitur me vlere totale sipas preventivit **pa TVSH 125 134 525 lekë**(njqind e njezet e pesemilion e njeqind e tridhjetë e kater mije e peseqind e

njezet e pese) dhe me TVSH 150 161 430 lekë (njqind e pesedhjetë milion e njqind e gjashtedhjetë e nje mije e katerqind e tridhjetë.), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Njesise se Prokurimit se Bashkise Fier, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Brigada e XI Sulmuese”, sigurimi e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **18.02.2017**.

Ankesa: ka ose jo, - **Po**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë **27.02.2017**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Armando SUBASHI

